



Projekte Vullnetare Ndërkombëtare



NATIONAL
YOUTH
CONGRESS

Raport Monitorimi

MONITORIMI I TRANSPARENCËS NË NIVELIN E QEVERISJES VENDORE

Vlerësimi i transparencës nga OJF-të Rinore,
të Rinjtë, Media në 15 bashki të vendit

Tiranë, Maj 2022



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

RAPORT MONITORIMI

Monitorimi i Transparencës në Nivelin e Qeverisjes Vendore.

Vlerësimi i transparencës nga OJF-të rinore/të rinjtë/media në 15 bashki të vendit.

Raporti u përgatit nga:

© **Projekte Vullnetare Ndërkombëtare**

Ky raport monitorimi u hartua në kuadër të Projektit “Nxitja e Llogaridhënies Politike në Pushtetin Lokal” i cili u zbatua nga Projekte Vullnetare Ndërkombëtare me mbështetjen financiare të National Endowment for Democracy.



Të dhënat për hartimin e këtij raporti u përfatuan nga analizimi i 15 raporteve vendore të transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor të hartuara nga kordinatorët lokale të OJF-ve rinore/individive të projektit në 15 Bashki si dhe nëpërmjet asistencës teknike të ofruar nga Projekte Vullnetare Ndërkombëtare.

**Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë botim u përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.*

Tiranë, Maj 2022

Tabela e Përmbajtjes

1-Hyrje.....	4
2. Kuadri Ligjor dhe Institucional për të Drejtën e Informimit në Nivel Lokal.	6
2.1 Kuadri ligjor	6
2.2 Kuadri Institucional për të Drejtën e Informimit dhe roli i të rinjve, OJF-ve rinore, medias në veçanti.....	8
3-Aksesi në Informacion	10
3.1 Monitorimi i transparencës nga aktorë jopublike, të rinjtë dhe media si aktorë të rëndësishëm për një mirëqeverisje vendore.	10
4-Metodologjia.....	12
5-Raportimi i gjetjeve në lidhje me transparencën për katër indikatorët e mëposhtëm	13
5.1-Transparenca proaktive në lidhje me OSHC-të dhe integrimin evropian- Indikator 1.....	13
Grafiku 1: Indiktori 1, Programi i Transparencës sipas zërave.....	14
Grafiku 2: Indikator 1- Transparenca proaktive në lidhje me OSHC-të dhe Integrimin Evropian.....	15
5.2- Transparenca proaktive në ëeb dhe mediat të Bashkisë/Indikator Nr. 2.....	16
Grafiku 3: Indikator 2- Transparenca në Website sipas zërave.	17
Grafiku 4: Indikator 2- Transparenca në Website.....	17
5.3 Transparenca proaktive në stendat në Bashki/ indikator nr 3.....	19
Grafiku 5: Indikator 3- Transparenca në Stenda informuese sipas zërave.	20
Grafiku 6: Indikator 3- Transparenca në Stenda informuese.....	20
5.4-Transparenca reaktive e informimit me kërkesë/indikator nr 4	22
Grafiku 5: Indikator 3- Transparenca reaktive e Informimit me kerkese sipas zërave.	23
Grafiku 5: Indikator 3- Transparenca reaktive e Informimit me kerkese.....	23
Përmbledhje e rezultateve përfundimtare dhe pasqyrimi i një performance në total për 15 bashkitë e monitoruara:	25
6- Rekomandime.....	27

1-Hyrje

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga elementët kryesorë të mirëqeverisjes duke patur në fokus rritjen e aksesit për informacion tek të gjithë qytetarët, në veçanti tek grupet e interesit si dhe uljen e korrupsionit.

Aksesi në informacionin publik është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe hapi i parë drejt demokracisë vendore me pjesëmarrje. Kjo e Drejtë në Shqipëri garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe detyron njësitë e vetëqeverisjes vendore si autoritete publike garantimin e kësaj të drejte si dhe sigurimin e transparencës në veprimtaritë e tyre.

Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies vendore nga aktorë jopublikë ka rëndësi në nxitjen dhe promovimin e qytetarisë aktive në proceset vendimarrëse dhe në veçanti në nxitjen e të rinjve si qytetarë aktivë në vendimarrjen lokale.

Ky proces i realizuar nga aktorë jopublikë dhe grupe interesi, OJF-të rinore lokale, të rinj dhe media bënë të mundur aftësimin dhe përfshirjen e tyre me qëllim sigurimin e një qeverisje vendore të hapur, transparente dhe një demokracie vendore të fortë.

Duke konsideruar themelore transparencën dhe llogaridhënien lokale, Projekte Vullnetare Ndërkombëtare mundësoi zbatimin e projektit “Nxitja e Llogaridhënies Politike në Pushtetin Lokal” nëpërmjet të cilin synonte të ndërtonte kapacitete të qëndrueshme të OJQ-ve rinore, të rinjve, mediave dhe aktorëve të tjerë qytetarë për të kuptuar të drejtën e aksesit në informacion dhe për të forcuar rolin e tyre proaktiv mbikëqyrës kundër korrupsionit në nivel lokal.

Ky projekt pati një shtrirje gjeografike në të gjithë vendin dhe përfshiu 15 bashki të cilat janë: Tiranë, Elbasan, Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Maliq, Devoll, Dibër, Fushë-Arrëz, Gjirokastër, Kamëz, Lushnje, Vlorë dhe Durrës.

Një nga aktivitetet kryesore në zbatim të këtij projekti është monitorimi i 15 Bashkive nga ana e OJF-ve lokale rinore dhe te rinjte, në lidhje me zbatimin e ligjit të informimit, transparencës dhe llogaridhënies. Monitorimi dhe vlerësimi i transparencës në këto 15 bashki të vendit u bë në lidhje me gjetjet referuar katër indikatorëve të mëposhtëm:

1. transparenca proaktive në lidhje me OSHC-të dhe integrimin evropian;
2. transparenca proaktive në web dhe mediat të bashkisë;
3. transparenca proaktive në stendat në bashki;
4. transparenca reaktive e informimit me kërkesë;

Gjatë periudhës tetor-nëntor 2021, 14 organizata të shoqërisë civile lokale rinore dhe aktorë të shoqërisë monitoruan dhe vlerësuan bashkinë përkatëse nëpërmjet (1) web-it zyrtar të tyre, (2) stendave informuese, (3) mjeteve mediatike të bashkisë dhe (4) informimit me kërkesë. Këto gjetje shërbyen për hartimin e 15 raporteve vendorë të monitorimit dhe përbëjnë bazën për hartimin e këtij raporti përfundimtar nëpërmjet analizës krahasuese dhe formimit të një panorame jo vetëm informuese për nivelin e transparencës në njësite vendore por dhe për dhënien e rekomandimeve përkatëse për do njësi vetëqeverisëse me qëllim përmirësimin e transparencës lokale.

Raporti është strukturuar në shtatë pjesë:

pjesa e parë, është hyrje e përgjithshme që shpjegon rreth qëllimit të raportit;

pjesa e dytë bën përmbledhje dhe analizë të kuadrit ligjor dhe institucional për të Drejtën e Informimit në nivel vendor;

pjesa tretë, tregon vlerën e pazëvendësueshme që ka në demokracinë vendore përfshirja e aktorëve jo publik në përgjithësi dhe të të rinjve në vecanti;

pjesa katër, shprehet rreth metodologjisë si instrument për procesin e monitorimit;

pjesa e pestë, shprehet rreth gjetjeve dhe analizës krahasuese të gjetjeve për katër indikatorë të rëndësishëm për transparencën lokale proaktive dhe aktive;

pjesa e gjashtë, jep përfundime dhe rekomandime të hartuara për përmirësimin e transparencës vendore;

2. Kuadri Ligjor dhe Institucional për të Drejtën e Informimit në Nivel Lokal.

2.1 Kuadri ligjor

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*

Eshte dokumenti themeltar i funksionimit të një shteti dhe i garantimit të të drejtave themelore të njeriut. Ajo garanton të drejtën e informimit për cilindo qytetar për të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore (neni 23) dhe ndërkohe na garanton për një qeverisje transparente dhe të hapur duke “u përfshirë në mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive”.

- *Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*

Ligji garanton të drejtën për informim në lidhje me informacionin që prodhohet dhe mbahet nga organet publike. Dispozitat e këtij ligji kane per qellim nxitjen e integritetit, transparencës, përgjegjshmërisë të autoriteteve publike. E drejta për informin është një e drejtë e cilitdo dhe në nenin 2 të këtij ligji është bërë përcaktimi se cili mund të jetë kërkues për informacion. Ligji parashikon informimin me kërkësë dhe informimin pa kërkësë pa shpjeguar motivet si dhe shpjegon detyrimin e institucioneve publike për të përmbushur këtë të drejtë duke respektuar kufizime të se drejtës për informim.

Informimi pa kërkësë është detyrimi i institucioneve publike për të publikuar në mënyrë proaktive një sërë informacionesh publike që prodhohen dhe disponohen prej tyre. Kjo realizohet nëpërmjet Programit të Transparencës i cili nënkupton tërësinë e informacionit dhe mënyrën për ta bërë publik atë nga institucioni publik. Neni 7 i këtij Ligji ka parashikuar të gjithë kategoritë e informacioneve që duhet të përmbajë Programi i Transparencës (PT), ndërsa neni 6 i këtij Ligji parashikon që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike. Një program i tillë është miratuar dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ligji për të drejtën e informimit ka hasur dhe vazhdon të hasë vështirsi në zbatimin e tij në përgjithësi dhe në njësitë e qeverisjes vendore në veçanti.

- *Ligji Nr. 139 /2014 “Për vetëqeverisjen vendore”*

Ligji rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri duke përcaktuar funksionet dhe kompetencat e tyre. E Drejta për Informim në nivel lokal për qytetarët përcaktohet dhe nga ky ligj duke siguruar kështu transparencës të punës së organeve lokale dhe mundësi për pjesëmarrje aktive në vetëqeverisje të qytetarëve. Ky Ligj i kushton rëndësi garantimit të së drejtës së informimit qytetareve dhe pjesmarrjen e tyre në vendimmarrje. Gjithashtu ky Ligj përfshin detyrimin e njësive vendore të garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre duke publikuar aktet në faqet zyrtarete internetit, duke i afishuar apo publikuar në media dhe adresa të tjera publike. Çdo njësi vendore

ka detyrimin të ketë koordinatoren e transparencës dhe miratojë Programin e Transparencës duke siguruar akses për të gjithë qytetarët e komunitetit pavarësisht pozitës ekonomike, sociale, arsimore apo distancimi fizik që ata kanë nga njësia e qeverisjes lokale.

- *Ligji Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative"*

Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë është një tjetër ligj që detyron organet publike të jenë transparente duke bashkëpunuar ngushtë me qytetarët dhe grupet e interesit. Në këtë Kod është sanksionuar parimi i informimit "Çdo preson ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik pa qënë i detyruar të shpjegojë motivet , në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtë e informimit." Kodi detyron administratën publike të jetë e hapur dhe transparente.

- *Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"*

Ky ligj ka për synim të nxisë transparencën, përgjegjshmërinë dhe integritetin e autoriteteve publike. Ai rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe lokale si dhe politikat me interes e lartë publik. Ligji gjithashtu rregullon të gjithë procedurat që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikeberese dhe vendimarrëse nga organet publike.

- *Ligji Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"*

Ligji "Për financat e vetëqeverisjes vendore" rregullon procedurat të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, transfertat nga qeverisja qendrore tek ajo vendore, përcaktimin e rregullave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për financimin e funksioneve të vetëqeverisjes vendore.

Ky ligj e parashikon parimin e transparencës në disa nene të tij, që lidhen me transfertat nga qeverisja qendrore tek ajo vendore, politikat e menaxhimit të fondeve publike, marrëveshjet që lidhin njësitë e qeverisjes vendore dhe shitjen/dhënien me qira të pronave dhe asetëve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, detyrimin e njësive të qeverisjes vendore për të publikuar dokumente me rëndësi, të tilla si vendimet për detyrimet fiskale vendore, bazën e taksave dhe tarifave, gjobat dhe kamatëvonesat e aplikueshme, asetet dhe pronat e ofruara për shitje ose dhënie me qira, dhe buxhetin vjetor. Ligji "Për financat e vetëqeverisjes vendore" është i rëndësishëm edhe për faktin se parashikon dokumentet financiare për të cilat njësia e qeverisjes vendore është e detyruar të kryejë konsultim publik, si p.sh., Programi Buxhetor Afatmesëm dhe taksat e perkohshme vendore.

- *Ligji Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"*

Ky ligj ka si qëllim kryesor rregullimin e shërbimit civil dhe marrëdhënies mes shtetit dhe nëpunësve civil, e rendit transparencën si një ndër parimet kryesore të administrimit të shërbimit civil. Gjithashtu, ky ligj

parashikon detyrimin e çdo nëpunësi civil (këtu përfshihet edhe administrata vendore) për transparencë dhe informim ndaj publikut: “Nëpunësi civil ka detyrimin të ushtrojë detyrën e tij në shërbimin civil me transparencë dhe të sigurojë për publikun e gjerë dhe palët çdo informacion të nevojshëm, me përjashtim të rasteve, kur ai është klasifikuar sekret shteteror sipas ligjit.

- *Ligji nr 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”*

Ky ligj në nenin 6 të tij, “Parimi i informimit” shpreh detyrimin e institucioneve qendrore, vendore etj për informim publik për rreziqet dhe për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera si dhe detyrimin të njoftojnë komunitetin e një zone të caktuar që rrezikohet të goditet nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

2.2 Kuadri Institucional për të Drejtën e Informimit dhe roli i të rinjve, OJF-ve rinore, medias në veçanti.

Aktorët që përfshihen në procesin e monitorimit të transparencës në nivel vendor janë si më poshtë:

1. **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** është autoriteti përgjegjës dhe i pavarur që mbikqyr dhe monitoron të drejtën e informimit për individët dhe shqyrton ankimmimet. Komisioneri sipas rastit u propozon bashkive përgjegjëse rekomandime apo dhe masa administrative përkatëse.
2. **Këshilli Bashkiak** si organi përfaqësues i bashkisë mbikëqyr informimin e publikut nga administrata e bashkisë; është përgjegjës për zhvillimin e seancave të këshillimit me publikun dhe konsultimeve; mbikëqyr garantimin e pjesëmarrjes publike në procesin e vendimmarrjes; Gjithashtu, Këshilli Bashkiak është organi që miraton Programin e Transparencës së bashkisë dhe informacionin përkatës sipas fushave të tij dhe si i tillë mund të ndër marrë nisma apo mekanizma për monitorimin e zbatimit të tij nga administrata e bashkisë.
3. **Kryetari i Bashkisë**, si organi ekzekutiv i bashkisë dhe titullari i institucionit, vlerëson dhe mbikëqyr të gjithë procesin e zbatimit të programit të transparencës nga ana e administratës së bashkisë, një sive administrative dhe një sive të varësisë. Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës do të bëhet jo më pak se një herë në vit nga ana e këshillit bashkiak dhe kryetarit të bashkisë nëpërmjet përdorimit të sistemit të matjes që shoqëron Programin model.
4. **Aktorët jopublikë**, ku përfshihen organizatat e shoqërisë civile, media, biznesi, qytetarët dhe grupe të ndryshme interesi, kanë një rol të rëndësishëm si mbikëqyrës të jashtëm të zbatimit të Programit të Transparencës. Ky rol është veçanërisht i rëndësishëm gjatë periudhave të emergjencave, duke i shërbyer jo vetëm monitorimit por edhe kërkesës për përgjegjshmëri më të lartë të vendimmarrësve vendorë, veçanërisht në rastet e nevojave emergjente të qytetarëve, si p.sh., rasti i tërmetit apo komuniteteve në nevojë në rastin e pandemisë për të siguruar ndihmë humanitare dhe shërbime,

fushata për mbledhjen e fondeve, si dhe duke rritur ndërgjegjësimin për problematika të ndryshme nëpërmjet denoncimit publik.

Është për t'u theksuar se pjesa më aktive e aktorëve jopublike janë ofj-të rinore, të rinjtë dhe media. Ata kanë energjinë dhe mundësinë për tu përfshirë në vendimarrje duke realizuar një qeverisje vendore transparente, duke rritur demokracinë vendore dhe duke minimizuar korrupsionin.

3-Aksesi në Informacion

3.1 Monitorimi i transparencës nga aktorë jopublike, të rinjtë dhe media si aktorë të rëndësishëm për një mirëqeverisje vendore.

Bashkitë janë niveli i qeverisjes pranë qytetarëve dhe ofruesit e shërbimeve publike në nivel vendor. Ata kanë një rol thelbësor në informimin publik dhe mundësimin e vendimmarrjes vendore me pjesëmarrje qytetare. Qasja në informacionin publik i fuqizon qytetarët për të kërkuar të drejtat e tyre, për të ndërmarrë veprime apo për të bërë zgjedhje të informuara dhe për tu bërë qytetarë më të përgjegjshëm e të angazhuar.

Një vlerë të madhe në këtë qasje ka përfshirja në veçanti e të rinjve dhe medias, duke siguruar kështu një përfshirje të të rinjve në vendimmarrje si dhe një proces informimi sa më koherent, të saktë dhe të qartë nëpërmjet medias.

Përfshirja e të rinjve në monitorimin e transparencës publike të pushtetit lokal i bën ata me të ndërgjegjshëm për rolin mbikqyres që ata kanë ndaj qeverisjes, ata jo vetëm nxisin pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje por sigurojnë të kenë një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse.

E drejta informimit është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe është e lidhur ngushtë me lirinë e fjalës. Ajo përkufizohet ndryshe dhe si “liria e shprehjes” e cila nënkupton të gjitha format e shprehjes: me shkrim, me gojë, nëpërmjet medias apo të gjithë formave të komunikimit. Dimë që e drejta informimit dhe liria e shprehjes janë të lidhur ngushtësisht me njera tjetrën dhe në rastin e komunikimit me pushtetin lokal ata sigurojnë komunikimin publik.

E drejta për informim e pare ne kendveshtrimin e te rinjeve do te thote ushtrimin e nje te drejte kushtetuese dhe ligjore nga ana tyre,do te thote qe te rinjte kane nje qasje koshiente ne informacion,do te thote qe ata jane pjese aktive ne bashkeqeverisje,dote thote se ata rrisin besimin ndaj institucionit te bashkise.Kjo do te siguroje nje komunikim te hapur dhe nje sinergji midis qytetareve dhe qeverisjes vendore.

Realizimi i të drejtës së informimit sigurohet nëpërmjet:

- pranisë së publikut/qytetareve në zyrat e informimit;
- publikimi proaktiv, koherent, i saktë dhe i qartë për qytetarët nëpërmjet ëeb-it të bashkisë në Programin e Transparencës;
- përdorimi i të gjithë rrjeteve sociale dhe mjeteve të informimit për informimin e qytetareve mbi çështje të ndryshme.

Monitorimi i transparencës nga aktorë jopublike dhe në veçanti nga të rinjtë dhe m

edia është shumëfunksional sepse do të thotë që nxit ndjeshmërinë ndaj mënyres se si e sa realizohet informimi dhe ndërkohë ushtron një ndikim pozitiv në mënyrë që bashkitë të përmirësojnë punën e tyre dhe llogaridhenien. Monitorimi i transparencës vendore nga aktorë jopublike bëhet shumë i rëndësishëm gjatë situatave të emergjencave apo fatkëqesive natyrore gjatë të cilave shumë të drejta të qytetareve

kufizohen. Në këto situatata duket qartë mirëqeverisja vendore se në çfarë niveli është duke qënë transparente dhe llogaridhënëse me qytetaret.

Monitorimi i transparencës vendore është kryer nga aktorë jopublike në kohë duke nxjerrë në pah performancën e njesive vendore, arritjet e tyre, për sfidat dhe pengesat që ata kanë hasur.

Qasjet krahasuese për nivelin e transparencës kanë treguar se njësitë vendore në vendin tonë kanë nivele të ndryshme performance që variojnë nga nivele të ulta deri në ato të larta dhe ky nivel performance nuk përcaktohet vetëm nga të qënit bashki e madhe apo e vogël, as nga të qënit bashki e vjeter apo e re por mbi te gjitha përcaktohet nga shkalla e përgjegjshmërisë së institucionit për të realizuar detyrimin ligjor dhe një nga misionet e saj bashkëqeverisjen.

4-Metodologjia

Metodologjia e monitorimit të Transparencës synon një monitorim të pavarur, objektiv dhe të paanshëm në zbatimim të ligjit të informimit nga 15 Bashkitë qendër qark. Nëpërmjet këtij raporti do të ofrohet një qasje krahasimore midis këtyre 15 bashkive qendër qark duke monitoruar Programin e Transparencës të publikuar në faqet e internetit.

Mekanizmi që do të përdoret është një sistem matjeje të Transparencës dhe Llogaridhënies i hartuar në kuadër të projektit “Nxitja e Llogaridhënies Politike në Pushtetin Lokal” dhe i realizuar nga OJF-të rinore, të rinjtë dhe media të aftësuar për ta kryer këtë proces. Sistemi i matjes ka për qëllim të realizojë një vlerësimin objektiv të të informacionit/dokumentacionit që duhet të publikohet në Programin e Transparencës, sipas parashikimeve të nenit 7 të Ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

Në rastin konkret vlerësimi është bërë duke monitoruar nivelin e transparencës proaktive dhe aktive në katër indikatorë duke bërë vlerësimin sasior dhe cilësor të secilit. Mbledhja e informacionit është bërë për secilën bashki dhe matja e transparencës në total në këta katër indikatorë do të përcaktojë dhe nivelin e qeverisjes vendore në llogaridhënie.

Katër indikatorët që u monitoruan janë:

1. transparenca proaktive në lidhje me OSHC-të dhe integrimin europian;
2. transparenca proaktive në ëeb dhe mediat të bashkisë;
3. transparenca proaktive në stendat në bashki;
4. transparenca reaktive e informimit përmes kërkesës për informim;

Vlerësimi/pikëzimi për secilën Bashki u krye për çdo indikator nga 0 pikë deri në 10 pikë dhe në total pikëzimi do të jetë ndërmjet vlerave zero pikë deri 40 pikë.

Ponderimi përcaktoi nivelin e transparencës të seciles Bashki sipas renditjes së mëposhtme:

- 0-20% transparencë e ulët;
- 21-40% transparencë pjesërisht e ulët;
- 41-60% transparencë mesatare;
- 61-80% transparencë pjesërisht e lartë;
- 81% - 100% transparencë e lartë;

Duhet theksuar se Programi i Transparencës mund të rishikohet një herë në pesë vjet, ndërsa përditësimi i tij duhet të bëhet rregullisht nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

5-Raportimi i gjetjeve në lidhje me transparencën për katër indikatorët e mëposhtëm

5.1-Transparenca proaktive në lidhje me OSHC-të dhe integrimin europian- Indikator 1.

Tabela 1: Të dhënat mbi Indikatorin e parë- Programi i Transparencës


Bashkia	Indikator 1 Programi i Transparencës					
	Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE	Në tërësi të dhëna për grupet e interesit	Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit	Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme	Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile	Total
Dibër	2	1	1	1	1	6
Devoll	2	1	1	0	1	5
Durrës	0	2	1	1	1	5
Elbasan	1	1	1	1	1	5
Fier	2	1	1	0	0	4
Fush-Arrez	2	1	1	2	1	7
Gjirokastrë	1	0	0	0	0	1
Kamëz	0	2	1	1	1	5
Korçë	2	0	0	0	2	4
Lushnje	2	2	2	1	0	7
Lezhë	2	2	0	1	1	6
Maliq	1	0	0	0	1	2
Vlorë	2	1	1	1	1	6
Shkodër	2	2	2	2	1	9
Tiranë	2	1	2	2	2	9

Përfundime në lidhje me gjetjet për indikatorin e parë, transparenca proaktive në lidhje me OSHC-të dhe integrimin europian.


Referuar gjetjeve dhe grafikut nr. 1 mësipër shohim që vlerësimi i këtij indikator mbështet në 5 kritere dhe nga analiza e përgjithshme del:

- Kriteri i parë: “Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE” është kryer plotësisht më së miri me maksimumin e vlerësimit (2 pikë) nga 10 bashki nga 15 gjithsej pra 66% e tyre;
- Kriteri i dytë: “Në tërësi të dhëna për grupet e interesit” është kryer në nivele të ulta dhe rezultojnë që 5 bashki ose 33.3% e tyre është në nivelin e vlerësimit max me 2 pikë;
- Kriteri i tretë: “Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit” është kryer në nivele të ulta, vetëm 3 bashki ose 20% e tyre është në nivelin maksimal të vlerësimit.
- Kriteri i katërt: “Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme” është kryer në nivele të ulta, vetëm 3 bashki ose 20% e tyre është në nivelin maksimal të vlerësimit.
- Kriteri i pestë: Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile” është kryer në nivele shumë të ulta, vetëm 2 bashki ose 13% e tyre është në nivelin maksimal të vlerësimit.

Grafiku 1: Indikatorin 1, Programi i Transparencës sipas zërave.



Grafiku 2: **Indikatori 1**- Transparenca proaktive në lidhje me OSHC-të dhe Integrimin Evropian



Rezultati përfundimtar nga monitorimi i 15 bashkive për indikatorin e parë, “transparenca proaktive në lidhje me OSHC-të dhe integrimin evropian” është:

- 2 Bashki ose 13% janë në nivele (vlerësimi 1-3) shumë të ulta të informimit në lidhje me këtë indikator;
- 11 Bashki ose 74% janë në nivel mesatar (vlerësimi 4-7) përsa i përket informacionit në lidhje me këtë indikator;
- 2 Bashki ose 13% janë në nivel të lartë (vlerësimet 8-10) pra kanë një transparencë proaktive në lidhje me OSHC-të dhe integrimin evropian në nivel shumë të mirë. Është për tu përmendur bashkia Shkodër dhe Tiranë.

PËRFUNDIM:

Bashkitë në lidhje “me transparencën proaktive në lidhje me OSHC-të dhe integrimin evropian” me shumë se gjysma e tyre paraqesin një nivel mesatar të transparencës dhe që lë vend për përmirësime.

5.2- Transparenca proaktive në ëeb dhe mediat të Bashkisë/Indikatorin Nr. 2

Tabela 2: Të dhëna mbi Indikatorin e dytë- Transparenca në Website


Bashkia	Indikatorin 2 Website					
	Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritit në BE	Në tërësi të dhëna për grupet e interesit	Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit	Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme	Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile	Total
Diber	2	1	1	0	1	5
Devoll	0	1	1	0	1	3
Durrës	0	1	2	1	1	5
Elbasan	1	1	2	1	0	5
Fier	2	1	1	0	0	4
Fush-Arrez	2	2	1	2	1	8
Gjirokaster	1	1	0	0	1	3
Kamez	0	1	2	1	1	5
Korçë	2	0	0	0	2	4
Lushnjë	2	2	2	2	0	8
Lezhë	2	1	1	0	1	5
Maliq	1	0	0	0	1	2
Vlorë	2	2	1	1	1	7
Shkoder	2	2	2	2	2	10
Tirana	2	1	2	1	2	8

Përfundime në lidhje me gjetjet për indikatorin e transparencës proaktive në web dhe mediat të bashkive.


Referuar gjetjeve dhe tabelës nr.2 mësipër shohim që vlerësimi i këtij indikator mbështet në 5 kritere dhe nga analiza e përgjithshme del:

- Kriteri i parë “Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtaritë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE” është kriteri i plotësuar më së miri me maksimumin e vlerësimit (2 pikë) nga 9 bashki nga 15 gjithësej pra 60% e tyre.
- Kriteri i dytë “Në tërësi të dhëna për grupet e interesit” është plotësuar në nivele të ulta dhe rezultojnë që 4 bashki ose 26% e tyre janë në nivelin e vlerësimit maksimal me 2 pikë.
- Kriteri i tretë “Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit” është plotësuar në nivele të ulta, vetëm 6 bashki ose 40% e tyre është në nivelin maksimal të vlerësimit.
- Kriteri i katërt “Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme” është plotësuar në nivele të ulta, vetëm 3 bashki ose 33% e tyre janë në nivelin maksimal të vlerësimit.
- Kriteri i pestë “Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile” është plotësuar në nivele shumë të ulta, vetëm 3 bashki ose 33% e tyre është në nivelin maksimal të vlerësimit.

Grafiku 3: Indikatorin 2- Transparenca në Website sipas zërave.



Grafiku 4: Indikatorin 2- Transparenca në Website.



Rezultati përfundimtar nga monitorimi i 15 bashkive për indikatorin e dytë, “transparenca proaktive në web dhe media të bashkisë” është:

- 3 bashki ose 20% janë në nivele (vlerësimi 1-3) shumë të ulta të informimit në lidhje me këtë indikator;
- 8 bashki ose 53% janë në nivel mesatar (vlerësimi 4-7) përsa i përket informacionit në lidhje me këtë indikator;
- 4 bashki ose 27% janë në nivel të lartë (vlerësimet 8-10) pra kanë një transparence proaktive në lidhje me OSHC-të dhe integrimin european në nivel shumë të mirë.
- Është për tu përmendur bashkia Shkodër, Tiranë ,Lushnje dhe Fushë-Arrëz.

PERFUNDIM:

Bashkitë në lidhje “**transparenca proaktive në web dhe mediat të bashkise**” paraqesin një nivel të transparencës që lë vend për përmirësime.

5.3 Transparenca proaktive në stendat në Bashki/ indikatori nr 3

Tabela 3: Të dhëna mbi Indikatorin e tretë- Transparenca në Stenda Informuese

Bashkia	Indikatori 3 Stenda					
	Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE	Në tërësi të dhëna për grupet e interesit	Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit	Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme	Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile	Total
Dibër	2	0	1	1	1	5
Devoll	1	1	0	1	0	3
Durrës	0	0	0	0	0	0
Elbasan	2	0	0	0	0	2
Fier	2	0	0	0	0	2
Fush-Arrez	2	2	2	1	1	8
Gjirokaster	0	0	0	0	0	0
Kamez	0	0	0	0	0	0
Korce	2	0	0	0	2	4
Lushnje	0	0	0	0	0	0
Lezhe	2	1	1	1	1	5
Maliq	1	0	0	0	1	2
Vlorë	2	1	-	-	-	3
Shkoder	2	2	2	1	1	8
Tirana	2	2	2	1	1	8

*Shënim: Për qytetin e Vlorës të dhënat mbi 3 zërat e fundit të këtij indikatori nuk janë mbledhur.

Referuar gjetjeve dhe tabelës nr 3 mesiper shohim që vleresimi i këtij indikatori mbështet në 5 kritere dhe nga analiza e përgjithshme del:

Kriteri i parë “Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE” është kriteri i plotësuar më së miri me maksimumin e vlerësimit (2 pikë) nga 9 bashki nga 15 gjithësej pra 60% e tyre.


Kriteri i dytë “Në tërësi të dhëna për grupet e interesit” është plotësuar në nivele të ulta dhe rezultojnë që 3 Bashki ose 20% e tyre është në nivelin e vlerësimit maksimal me 2 pikë.

Kriteri i tretë “Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit” është plotësuar në nivele të ulta, vetëm 3 Bashki ose 20% e tyre është në nivelin maksimal të vlerësimit.


Kriteri i katërt “Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme” është plotësura në nivele shumë të ulta, pra 0% ose asnjë bashki nuk është në nivelin maksimal të vlerësimit.

Kriteri i pestë “Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile” është plotësura në nivele shumë të ulta, vetëm 1 Bashki ose 0.06% e tyre është në nivelin maksimal të vlerësimit.

Grafiku 5: Indikatori 3- Transparenca në Stenda informuese sipas zërave.



Grafiku 6: Indikatori 3- Transparenca në Stenda informuese.



Rezultati perfundimtar nga monitorimi i 15 bashkive per indikatorin e *Dyte,*” transparencja proaktive në stendat në bashki” eshte;

4 Bashki ose 27% janë me një vlerësim 0, minimal në lidhje me këtë indikator.

5 bashki ose 33 % janë në nivele (vlerësimi 1-3) shumë të ulta të informimit në lidhje me këtë indikator, me shumë se gjysma e bashkive të monitoruara.

3 bashki ose 20% janë në nivel mesatar (vlerësimi 4-7) për sa i përket informacionit në lidhje me këtë indikator

3 bashki ose 20% janë në nivel të lartë (vlerësimet 8-10) pra kanë një transparencë proaktive në lidhje me OSHC-të dhe integrimin evropian në nivel më të mirë.

Eshtë për të përmendur bashkia Shkoder, Tirane dhe Fushe-Arrez.

PERFUNDIM:

Bashkitë në lidhje “**transparencja proaktive në stendat në bashki**” paraqesin një nivel të transparencës që le shumë vend për përmirësime.

5.4-Transparenca reaktive e informimit me kërkesë/indikator nr 4

Tabela 4: Të dhëna mbi Indikatorin e katërt- Transparenca reaktive e informimit me kerkese

Bashkia	Indikator 4 Informimi me kerkese					
	Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE	Në tërësi të dhëna për grupet e interesit	Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit	Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme	Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile	Total
Diber	2	1	1	1	1	6
Devoll	1	2	0	1	0	4
Durres	0	1	1	1	1	4
Elbasan	2	1	1	1	1	6
Fier	2	2	2	2	2	10
Fush-Arrez	2	2	2	2	1	9
Gjirokaster	1	0	0	0	1	2
Kamez	0	1	1	1	1	4
Korce	2	0	1	0	2	5
Lushnje	2	2	2	2	0	8
Lezhe	2	2	1	2	1	8
Maliq	1	0	1	0	1	3
Vlorë	1	1	2	1	0	5
Shkoder	2	2	2	2	1	9
Tirana	2	2	1	2	2	9

Perfundime ne lidhje me gjetjet per “transparenca reaktive e informimit me kërkesë” ne bashki.

Referuar gjetjeve dhe tabelës nr 4 mesiper shohim qe vleresimi i ketij indikator mbeshtet ne 5 kritere dhe nga analiza e pergjithshme del:

Kriteri i pare “Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE” eshte kriteri i plotesuar me se miri me maksimumin e vleresimit (2 pike) nga 9 bashki nga 15 gjithsej pra 60% e tyre.


Kriteri i dyte "Në tërësi të dhëna për grupet e interesit" është plotësuar ne nivel mesatar dhe rezultojnë që 7 bashki ose 60% e tyre është ne nivelin e vleresimit maksimal me 2 pike.

Kriteri i trete "Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit" është plotësuar ne nivele te ulta, vetem 5 bashki ose 33% e tyre është ne nivelin maksimal te vleresimit.


Kriteri i katert "Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme" është plotësuar ne nivel te ulët, vetem 7 bashki pra 60% .

Kriteri i peste "Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile" është plotësuar ne nivele shume te ulta, vetem 3 bashki ose 20% e tyre është ne nivelin maksimal te vleresimit.

Grafiku 5: Indikatori 3- Transparenca reactive e Informimit me kerkese sipas zërave.



Grafiku 5: Indikatori 3- Transparenca reactive e Informimit me kerkese.



Rezultati pwrfundimtar nga monitorimi i 15 bashkive **pwr indikatorin e Katwrt,“** **transparenca reaktive e informimit me kërkesë” eshte;**

2 bashki ose 14% jane ne nivele (vleresimi 1-3)shume te ulta te informimit ne lidhje me kete indikator.

7 bashki ose 46% jane ne nivel mesatar(vleresimi 4-7) persa i perket informacionit ne lidhje me kete indikator

6 bashki ose 40% janene nivel te larte(vleresimet 8-10) pra kane nje transparence proaktive ne lidhje me OSHC-te dhe integrimin europian ne nivel me te mire.

PERFUNDIM:

Bashkitë në lidhje **“transparenca reaktive e informimit me kërkesë”** paraqesin një nivel të transparences që ka rezultatet më të mira krahasuar me të gjithë indikatorët e tjerë. 80% e bashkive të monitoruara kanë rezultuar në lidhje më këtë indikator me një performancë të transparencës mesatare e lart. Kjo tregon se me futjen e Programit të Transparences (shoqeruar ky edhe me sanksionet perkatese) si detyrim për bashkitë, bëhet shkak për një procedim korrekt ndaj detyrimeve ligjore. Kjo shpjegon se sa e rëndesishme është që një ligj i shkruar sic është ligji “E drejta për informim” të ketë dhe mekanizma të qartë për zbatim dhe kontrollim. Kjo jo vetëm rrit përgjegjshmërinë e njesive vendore por ndërkohe bëhet një mënyrë të të vepruari nga ana e administrates së njesisë vendore. Mekanizmat e qartë ligjorë përbëjnë garanci për funksionimin e saktë të demokracisë në nivel vendor.

Përmbledhje e rezultateve përfundimtare dhe pasqyrimi i një performance në total për 15 bashkitë e monitoruara:

Referuar rezultateve të mësipërme niveli i Transparencës për secilen bashki paraqitet si më poshtë:

Tabela 5: Të dhëna mbi performancën e përgjithshme të transparencës

Bashkia	Niveli i Transparencës					
	Rezultatet e Indikatorit nr 1	Rezultatet e Indikatorit nr 2	Rezultatet e Indikatorit nr 3	Rezultatet e Indikatorit nr 4	Totali pikeve	Niveli transparencës
1. Dibër	6	5	5	6	22	mesatare
2. Devoll	5	3	3	4	15	mesatare
3. Durrës	5	5	0	4	14	Pjeserisht e ulet
4. Elbasan	5	5	2	6	18	mesatare
5. Fier	4	4	2	10	20	mesatare
6. Fush-Arrez	7	8	8	9	32	pjeserisht e larte
7. Gjirokastrë	1	3	0	2	4	ulet
8. Kamëz	5	5	0	4	14	pjeserisht e ulet
9. Korçë	4	4	4	5	17	mesatare
10. Lushnje	7	8	0	8	23	mesatare
11. Lezhë	6	5	5	8	24	pjeserisht e larte
12. Maliq	2	2	2	3	9	pjeserisht e ulet
13. Vlorë	6	7	3	5	21	mesatare
14. Shkoder	9	10	8	9	36	e larte
15. Tirana	9	8	8	9	34	e larte

Më poshtë është paraqitur tabela e ponderimit si instrument vlerësues i cili u përdor për vlerësimin e transparencës në bazë të pikëve totale të mbledhura pas monitorimit të secilës Bashki.

Nr.i pikëve totale	Përqindja	Niveli i transparencës
0-7	0-20%	transparencë e ulët;
8-15	21-40%	transparencë pjesërisht e ulët;
16-23	41-60%	transparencë mesatare;
24-32	61-80%	transparencë pjesërisht e lartë;
33-40	81-100%	transparencë e lartë.

PËRFUNDIMI:

Niveli, **transparencë e lartë**, e kanë dy bashki ose 13% e tyre. Këto janë Shkodra dhe Tirana të cilat kanë një nivel pikësh përkatësisht 36 ose 90% dhe 34 pikë ose 85 % të nivelit të vlerësimit të transparencës si detyrim ligjor në punën e tyre në zbatim të “Drejtës së Informimit”.

Dy bashki, Fushë-Arrez dhe Lezhe kanë dalë me nivel transparencë **pjesërisht të lartë** dhe përbejnë 13% të totalit të bashkive.

Nga rezultatet shihet se në 15 bashkitë e monitoruara 7 bashki ose 47% të tyre kanë rezultuar **me nivelin mesatar të performancës** dhe këto janë: Dibër, Devoll, Elbasan, Fier, Korçë, Vlorë dhe Lushnjë. Ndërsa 3 bashki ose 20% e tyre përkatësisht Kamëz, Maliq dhe Durrës kanë dalë me **nivelin pjesërisht të ulët**. Një bashki ose 0.06% dhe përkatësisht bashkia Gjirokastrë ka dalë me **nivel transparencë të ulët**.

Është për tu theksuar se ky monitorim jep një rezultat deri diku të kënaqshëm në lidhje me nivelin e transparencës të dale nga monitorimi i këtyre 15 bashkive por ndërkohë ky monitorimi vë në pozita pune 7 Bashkitë me nivel mesatar për ta përmirësuar atë dhe detyron që 4 bashki me nivel të ulët ose pjesërisht të ulët të përmirësojnë sa më parë ndjeshëm punën e tyre në lidhje me zbatimin e Programit të Transparencës dhe të ligjit “Për të drejtën e Informimit”.

6- Rekomandime

1. Bashkitë duhet të **përdorë me efikasitet dhe saktësi të gjithë llojet dhe rruget e komunikim-informimit me qytetaret** duke mundësuar mbulimin gjeografik të juridiksionit të saj territorial, duke iu përgjigjur çdo qytetari pavarësisht nivelit ekonomik-social dhe kulturor apo distancës fizike nga Bashkia Qendër.
2. **Cilësia dhe përzgjedhja e mjeteve informative** prekin transparencën, duhet menduar për një përdorim teknologjik cilësor/inovativ pranë çdo bashkie në mënyrë që të mos bëhet pengesë për realizimin e transparencës.
3. Bashkia duhet të ketë **në përditshmerine e saj e detyrës së saj funksionale të informimit në kohë dhe qartë të çdo qytetari** në veçanti për aktivitete/vendime që prekin cilësinë e jetës së qytetarit, shërbimet më të domosdoshme ndaj tij.
4. Informimi qytetar është një proces kompleks dhe **kërkon rritje të kapaciteteve në administratën e bashkisë** për të mundësuar realizimin e një zinxhiri funksional ku çdo hallkë duhet të ketë një aftësi teknike me vete dhe të mos kthehet vetëm Programi i Transparencës dhe kordinatori i tij si përgjegjesit e vetëm në informim, kthim përgjigje etj.
5. Bashkia duhet të ndërtojë **një sistem funksional, hierarkik të realizimit të informimit qytetar** për çfarëdo info që siguron transparencë të aktiviteteve, nismave, vendimeve e saj apo të grupeve të interesit duke u siguruar kështu për informimin e saktë.
6. Bashkia **duhet të masë, vleresojë transparencën e saj në mënyrë periodike** dhe nëpërmjet saj të ngrejë objektivat në plane afatshkurtër për përmirësimin e vazhdueshëm të saj.
7. Bashkia **duhet të mbajë lidhje efektive në shërbim të qenit transparent** me grupet e interesit, me të rinjtë, me OSHC-ne, me strukturat e saj si KSVP-te që janë me afër qytetarit, me median lokale etj. Kjo duhet të jetë e pasqyruar me një skemë konkrete funksionimi.
8. Bashkia duhet të **pasqyrojë me një gjuhë të qartë, të kuptueshme çdo informacion publik** të saj duke e bërë kështu qytetarin të jetë një pjesëmarrës dinamik në bashkëqeverisje dhe pse jo një suportues në qeverisjen e saj.
9. Bashkia **të promovojë në bashkëpunim me aktorë lokale ndërgjegjen qytetare** me standarte europiane të një qytetarie aktive, të informuar dhe të përfshirë në qeverisje të hapur lokale.
10. **Përmirësimi i vazhdueshëm i Transparencës nga Bashkia** do ta përgatisë atë për procesin e decentralizimit të pushtetit vendor që do të thote do ta aftësojë më tepër në zhvillimin dhe forcimin e një pushteti lokal të pavarur dhe të aftë të vetëqeverisë në nivel lokal. Kjo është dhe një nga standartet që duhet plotësuar nga njesitë e qeverisjes vendore për tu bërë pjesë e familjes së madhe të BE.